



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

RELACION PËRSHKRIMOR

OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE TË BRENDSHME TË BLOKUT TË VRESHTIT, LAGJJA E RE”

1. Gjendja aktuale

Rruga e cila do ti nenshtrohet rikonstruksionit ndodhet ne “Lagjien e Re”, ne pjesen jug-perendimore te qytetit te Patosit dhe perfshin degezime te rrugeve ne vazhdim te rruges se Vreshtit. Gjatesia totale e rruges shkon 2350 m. Gjatesite perkatese te degezimeve qe perfshihen ne kete rruge jane perkatesisht:

1. Rruga “Vreshti” 53 m
2. Rruga “Tomorri” 163 m
3. Rruga “Qerim Gropa” 228 m
4. Rruga “Riza Cerova” 390 m
5. Rruga “Liri Gero” 228 m
6. Rruga “Arben Boci” 700 m
7. Rruga “Lefter Talo” 588 m



Gjendja aktuale e kësaj rruge është në kushte jo të mira për arsye se në këtë segment nuk janë bërë ndërhyrje të mirefillta, duke u bërë shkak për amortizimin e vazhdueshëm deri në gjendjen në të cilën ndodhet sot.

Problematikë për këtë segment rrugor mbetet edhe mungesa e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, mungesa e trotuareve dhe ndricimi rrugor. Kanalizimet e ujrave të bardha mungojnë plotësisht ndërsa për ujrat e zeza, segmente të caktuara janë të pajisura me sisteme kanalizimi ndërsa të tjerat kanë nevojë për plotësime.






Foto te gjendjes ekzistuese

Në këto kushte ky segment është problematik për banorët dhe automjetet që qarkullojnë dhe konsiderohet e domosdoshme ndërhyrja në rikonstruksionin, sistemimin dhe përmisimin e qarkullimit në zonë.

Përshkrim i Projektit


Projekti parashikon ndërhyrjen në të gjithë gjatësinë e këtyre segmenteve. Bazuar në karakteristikat e ndërhyrjeve në trupin e rrugës dhe tipin e profilit tërthor, segmentet rrugore do të trajtohen si më poshtë:


Rruga e Vreshtit: Elementët përbërës kryesor të këtij segmenti janë karrexhata, e cila ka një gjërësi asfalti prej 4 m ose 400 cm dhe do të jetë me pjerresi të dyanshme, kuneta prej betoni me gjerësi 40cm, t=10cm dhe pjerresi 10% dhe bordura të parapergatitura 20x35 cm.



Rruga Tomorri: Ky segment do te kete gjeresi karrexhate 3.5 m.

Rruga Liri Gero: Ky segment nga pike takimi me rrugen e Vreshtit deri ne pike takimin me rrugen Qerim Gropa do te kete gjeresi karrexhate 4 m, me pjerresi te njeanshe ne kahun e poshtem ku do te pajiset me kunete betoni 40cm dhe bordure te parapergatitur 20x35 cm dhe ne pjesen fundore me mur mbajtes b/a. Kahu i siperm, rreth 55m nga kryqezimi me rrugen Qerim Gropa do te kete trotuar me pllaka me gjeresi 1m, te konturuar me bordure te parapergatitur 20x35cm me rrugen dhe kunderbordure 6x10 cm ne kahun e banesave. Segmenti pike- takimi Qerim Gropa deri ne pike-takimin me Riza Cerova do te kete nje gjeresi karrexhate 3 m.







Rruga “Qerim Gropa” do te kete gjeresi karrexhate 4 m.

Rruga “Riza Cerova” do te kete gjeresi karrexhate 3 m.

Rruga “Lefter Talo” do te kete gjeresi karrexhate 4 m. Nga pike takimi me rrugen Qerim Gropa deri ne pike takimin me rrugen Arben Broci, ky segment do te kete karrexhate 4 m me pjerresi te njeanshe ne kahun e poshtem ku do te pajiset me kunete betoni 40cm dhe bordure te parapergatitur 20x35 cm dhe trotuar me pllaka me gjeresi 1 m, te pajisur me kunderbordure 6x10 cm. Nga pike takimi me rrugen Arben Broci deri ne pjesen fundore, do te trajtohet vetem karrexhata e rruges me gjeresi 4 m, ndersa degezimet fundore me gjeresi 3 m.




Rruga “Arben Broci” do te kete gjeresi karrexhate 3 m. Pjesa e rruges nga pike takimi me “Lefter Talon” deri ne pike takimin me “Vreshtin” rruga do te pajiset me kunete 40 cm dhe bordure 20x35 cm fillimisht ne kahun e majte dhe me pas ne kahun e djathte.



Segmentet rrugore do te pajisen me paketen e shtresave: Shtrese Cakelli 15 cm, Stabilizant 10 cm, Binder 5 cm, asfaltobeton 3 cm.

Ndricimi rrugor. Projekti perfshin gjithashtu ndricimin e rruges pergjate gjithë segmenteve duke perfshire dhe degezimet. Jane parashikuar vendosje shtylla ndricimi me lartesi 7 m, me ndricim Led 70W + Panel Fotovoltaik + bateri, ne distance rreth 30-35 m larg nga njera tjetra.



Kanalizimet e ujrave

Nje element i rendesishem i nderhyrjeve te projektit eshte ndertimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha dhe ujrave te zeza. Pergjate rruges Lefter Talo ne kahun e trotuarit, pergjate kunetes do te ndertohen puseta b/a shiu 40x40 cm ne distance 18 ml, te lidhur me tuba te brinjezuar Ø200 mm, te cilat do te shkarkojne ne puseten 80x80 cm, H=150 cm, qe do te ndertohet ne pike takimin me rrugen "Qerim Gropa". Linja e ujrave te zeza do te vazhdoje pergjate rruges "Liri Gero" me puseta 80x80cm, h=150cm dhe tuba te brinjezuar Ø250 mm ku do te bashkohen me linjen e ujrave mixe te rruges "Arben Boci", per te vazhduar pergjate rruges "Vresht" me tuba te brinjezuar Ø315 mm dhe puseta kontrolli 1x1x1.5. Ne pjesen fundore ujrart mixe te rruges "Vresht" dhe "Tomorri" do te shkarkojne ne pusetat dhe linjen e kanalizimeve te rruges se Perroit Cam, te parashikuara per tu ndertuar ne projektin ne fjale. Nje tjeter linje e kanalizimit te ujrave te zeza do te ndertohet nga pike takimi i rruges "Qerim Gropa" me rrugen "Tomorri" deri ne pjesen fundore te rruges "Qerim Gropa" duke perdorur tuba te brinjezuar Ø250 mm dhe Ø315 mm dhe puseta 80x80, h=150cm me pike shkarkimi kanalit fundor qe derdhet ne perrua. Ndertimi i linjes se re te kanalizimeve do te behet ne pershtatje edhe me linjat ekzistuese te trasuara ne keto rrugica ku ne pika te caktuara do te behet bashkimi i tyre.

Punoi: Silvana Mici